



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 44 prot.

Tiranë, më 19.1.2023

- Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 24.1.2023, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Enkeleda Osmani (Xhengo)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 15.10.2020, është njoftuar vendimi nr. 275, datë 20.7.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik, mbështetur dhe në jurisprudencën gjyqësore të Kolegjit, parashtron para këtij trupi gjykues, shqyrtimin dhe vlerësimin e rrethanave të faktit, shkaqet e këtij ankimi, në lidhje me kontrollin e kriterit të pasurisë, konkretisht: (i) të ardhurat e deklaruar, si të realizuara nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, për të cilat në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, nuk arrihet të provohet se janë të ardhura të realizuara nga një burim i ligjshëm

dhe janë paguar detyrimet tatimore<sup>1</sup>, marrë në konsideratë dhe mënyrën e pretenduar të kryerjes së pagesave të përfituara; (ii) mosmarrja në konsideratë e të ardhurave, pagesat e detyrimeve tatimore mbi të cilat janë kryer gjatë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit<sup>2</sup>; (iii) vlera provuese dhe rëndësia e kontrollit të deklaratave të interesave privatë periodikë/vjetoë<sup>3</sup>, në vëmendje të orientimit të Kolegjit në këtë rast, për të mos prezumuar përdorimin e likuiditeteve *cash*, si burim për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit<sup>4</sup>.

Për sa më sipër, Komisioneri Publik, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të paraqitur, kërkon shqyrtimin dhe rivlerësimin e këtij rasti nga Kolegji, lidhur me krijimin e të ardhurave të ligjshme të pasurive të deklaruara, si dhe vlerësimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për vitet 2012 dhe 2015, për sa do të trajtohet në vijim.

## 1. Për pasurinë apartament banimi, me sip. 111,87 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë

1.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi, me sip. 111,87 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë. Vlera: 50.341 euro. Pjesa takuese: 50%. Blerë me kontratën e sipërmarrjes (porosisë) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.11.2006, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. *Burimi i krijimit*: (i) kursime nga të ardhurat nga paga; (ii) hua në shumën 10.000 euro nga prindërit e bashkëshortit, \*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*; si dhe (iii) shuma 6.000 euro, dhuratë nga motra e bashkëshortit të subjektit, znj. \*\*\*.\*\*\*.

1.2 Krijimin e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar edhe në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008, sikundër trajtuar më gjerësisht në ankim.

1.3 Lidhur me burimin e deklaruar: *kursime nga pagat*, ka rezultuar se për vitet 2006 – 2009 (periudhë gjatë së cilës është likuiduar çmimi i pasurisë), subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore, përveç të ardhurave të saj si prokurore, edhe të ardhura të bashkëshortit si i punësuar pranë disa shoqërive tregtare<sup>5</sup>, deklaruar në shumën totale prej rreth 5.200.000 lekë për këtë periudhë.

1.4 Për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit për periudhën në fjalë, nga korrespondenca e Komisionit me institucionet shtetërore<sup>6</sup>, konfirmohet vetëm pagesa e detyrimeve tatimore pranë shoqërisë “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., për të ardhurat, respektivisht, në shumën 106.072 lekë

<sup>1</sup> Shihni ndër të tjera, vendimet (JR) nr. 3/2018, prg. 24; nr. 7/2018, prg. 52; nr. 19/2019, prg. 22.13; nr. 32/2019, prg. 56; dhe vendimin nr. 20/2021, prg. 33 etj.

<sup>2</sup> Shihni vendimin nr. 23/2020, prg. 24.13; nr. 24/2020, prg. 16.4; vendimin nr. 11/2022, prg. 33.15 etj.

<sup>3</sup> Shihni, ndër të tjera, vendimet (JR) nr. 6/2018, prg. 14; nr. 8/2018, prg. 43; nr. 9/2018, prg. 42; nr. 11/2018, prg. 17, 17.5 dhe në vijim; nr. 12/2018, prg. 24.11; nr. 5/2019, prg. 23; nr. 10/2018, prg. 67; nr. 19/2019, prg. 22.14; nr. 20/2019; nr. 5/2020; nr. 27/2020; nr. 11/2022, prg. 30.7 etj.

<sup>4</sup> Shihni vendimin orientues (JR) nr. 7/2019, prg. 39; si dhe vendimin nr. 19/2019; nr. 33/2020; nr. 13/2021 etj.

<sup>5</sup> Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka siguruar të ardhura nga punësimi pranë “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në vlerën totale 2.560.000 lekë, për vitet 2006-2009; “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën totale 990.000 lekë, për vitet 2007-2009; “\*\*\*\*.\*\*\*”, person fizik, në vlerën totale 1.200.000 lekë për vitin 2009 dhe “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në vlerën totale prej 250.000 lekë për vitin 2009.

<sup>6</sup> Arkivin Qendror dhe Drejtoritë Rajonale të ISSH-së dhe Tatimeve.

për vitin 2005; 119.042 lekë për vitin 2006 dhe 86.333 lekë për vitin 2007<sup>7</sup>. Bazuar në këtë shkresë, rezulton se punëdhënësi, “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ka paguar detyrime tatimore për punëmarrësin, bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 2003 – 2007 (me shkëputje), për paga bruto që variojnë nga 9.403 lekë deri në 48.611 lekë, shuma të cilat nuk përputhen me pagën mujore të deklaruar prej 80.000 lekësh, pasqyruar dhe në vërtetimin e lëshuar nga kjo shoqëri për efekt të procesit të rivlerësimit. Nuk rezulton që për këtë marrëdhënie punësimi të jetë depozituar kontratë pune, si dhe nuk konfirmohet që pagesat e pretenduara të kenë kaluar nëpërmjet sistemit bankar apo në një nga mënyrat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

1.5 Për sa i përket punëdhënësve, subjekteve tregtare “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratat respektive të punës<sup>8</sup>, por nga institucionet publike nuk konfirmohet që për periudhën në fjalë të jenë paguar detyrimet tatimore, sigurimet shoqërore, si dhe nuk dokumentohet kalimi i pagave nëpërmjet sistemit bankar apo ndonjë formë tjetër të parashikuar nga ligji.

1.6 Në këto kushte, lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të krijuar këtë pasuri, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: [...] (i) subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën prej - 3.349.875 lekësh për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare; (ii) ka mospërputhje të deklaramit të subjektit në vitet 2006 – 2009, për të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit, sipas dokumentacionit të lëshuar nga subjektet tregtare “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*.\*\*\*” dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., krahasuar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga ISSH-ja [...].

1.7 Komisioni, në analizë të prapësimeve të subjektit, ndër të tjera, pasi ka arsyetuar: [...] se për këtë çështje duhet aplikuar parimi i objektivitetit që lidhet me pamundësinë e subjektit për të provuar marrjen dijeni të mospagimit të detyrimeve në favor të tij. Në këtë kontekst, rrethanat faktike dhe ligjore diktojnë që, proporcionalisht, nuk gjendemi përpara arsyeve të mjaftueshme për të aplikuar ndonjë masë disiplinore të parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016<sup>9</sup> [...], i ka konsideruar si të ardhura të ligjshme, shumat e deklaruara të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., duke arsyetuar se: [...] subjekti ka kryer deklaramit të saktë dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe subjekti ka burime financiare të ligjshme për krijimin e saj për vitet 2006 – 2009, pavarësisht balancës negative prej 143.348 lekësh, të rezultuar në vitin 2008, vlerë kjo që, nëse do të

<sup>7</sup> Referohuni vërtetimit nga Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*/9.2019. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me punëdhënësin “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka depozituar një vërtetim (pa datë), lëshuar nga administratori i kësaj shoqërie, tashmë me status “shoqëri në likuidim e sipër”, ku, ndër të tjera, deklarohet se: [...] z. \*\*\* ka punuar pranë shoqërisë sonë, me profesion inxhinier ndërtimi, nga periudha korrik 2002 deri në gusht 2008 dhe se është angazhuar me kohë të plotë me detyra të ndryshme, me pagë mujore 80.000 lekë [...].

<sup>8</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., e datës \*\*/5.2007, me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit, për pagë mujore 50.000 lekë/muaj dhe kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*/7.2009, me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e punëdhënësit, për pagë mujore 50.000 lekë/muaj.

<sup>9</sup> Referohuni më gjerësisht f. 30 – 33 të vendimit, analiza e provave dhe e fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm.

*përfshiheshin të ardhurat nga punësimi në shoqëritë për të cilat është ngritur padi gjyqësore, subjekti do të gjendej në balancë pozitive [...].*

1.8 Ndërkohë, në vendimin e Komisionit, provueshmëria e ekzistencës së marrëdhënieve të punësimit me subjektet tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në raport me verifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, përkundër pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, është konstatuar se mbetet në nivel deklarativ<sup>10</sup>.

1.9 **Komisioneri Publik**, në analizë të rrethanave juridike të provuara dhe situatës faktike të konstatuar si më sipër, për pasurinë *apartment banimi me sip. 111,87 m<sup>2</sup>*, ndodhur në Tiranë, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të bazuara në prova, në ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, pasi:

1.9.1 Rezulton se në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të përfituara nga shoqëria “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit, në DV-2006 deri në DV-2008, ka deklaruar të ardhura vjetore në shumën totale 2.560.000 lekë. Kjo marrëdhënie punësimi: (i) nuk provohet të jetë në formën e një marrëdhënieje të rregullt punësimi midis palëve; (ii) vlera e deklaruar e pagës nuk provohet të jetë kaluar rregullisht nëpërmjet sistemit bankar; dhe (iii) për vitet 2006-2008, subjekti nuk rezulton të ketë provuar marrjen e shumave të deklaruara në asnjë nga mënyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

1.9.2 ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2019, konfirmon se, për periudhën janar 2003 – nëntor 2006, z. \*\*\*\*.\*\*\* ka realizuar të ardhura nga puna pranë subjektit “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., për të cilat janë derdhur kontributet, duke u llogaritur për shumën e të ardhurave neto në masën rreth 311.447 lekë<sup>11</sup>.

1.9.3 Fakti i mospagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga shoqëria “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., konfirmohet edhe nga deklarimi i ish-administratorit dhe ortakut të kësaj shoqërie, thirrur në cilësinë e dëshmitarit pranë Komisionit, i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se ka depozituar në datën \*\*.11.2019, shumën prej 444.624 lekë në llogarinë e personit të lidhur me subjektin, shumë e cila është përdorur nga ky i fundit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura tatimore, gjobave dhe kamatëvonesave të llogaritura, deklaruar në DIVA 2011.

1.9.4 Në kuadrin e verifikimit të ekzistencës së dijenisë të personit të lidhur mbi vlerën e pagesës mujore të përfituar si pagë, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, referohet edhe deklarimi i ish-administratorit dhe ortakut të kësaj shoqërie<sup>12</sup>, ku pranohet se personi i lidhur një pjesë të të ardhurave mujore nga paga i ka tërhequr *cash* nga financa e shoqërisë dhe pjesën tjetër nëpërmjet çeqeve bankare.

<sup>10</sup> Referohuni arsyetimit, f. 34 të vendimit.

<sup>11</sup> Për dy subjektet e tjerë punëdhënës, “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., nuk konfirmohet pagesa e detyrimeve për periudhat e pretenduara.

<sup>12</sup> Referohuni deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.11.2019, dhe deklarimeve para Komisionit, datë 20.2.2020.

1.9.5 Në këto rrethana, në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, për efekt të procesit të rivlerësimit, vetëm shuma si më sipër (prg.1.8.2), konfirmuar nga ISSH-ja, mund të konsiderohet në mesin e burimeve të të ardhurave të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, që kanë shërbyer për kryerjen e pagesave për blerjen e pasurisë *apartament banimi*, për vitet 2006-2008, bazuar kjo edhe në përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, dhe praktikës së Kolegjit.

1.9.6 Në vijim të këtij arsytimi dhe jurisprudencës së Kolegjit mbi konsiderimin e të ardhurave të ligjshme nga punësimi, vetëm në rastet kur përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara në nenin D, pika 3 e aneksit të kushtetutës dhe kur provohet përfitimi i të ardhurave në ndonjë nga format e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, vlerësohet se, nga analiza financiare për vitet 2006, 2007 dhe 2008, nuk mbulohen me të ardhura të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur me të, shpenzimet dhe investimet e kryera, dhe blerja e pasurisë në fjalë.<sup>13</sup>

2. Për pasurinë: *apartament banimi me sip. 45,6 m<sup>2</sup>, i ndodhur në \*\*\* – Kavajë dhe pasurinë autoveturë “Audi”*.

2.1. Në Deklaratën “*Vetting*”, subjekti i rivlerësimit, znj. Osmani (Xhengo), ka deklaruar: *Apartment banimi, \*\*\* - Kavajë, me sipërfaqe 45,6 m<sup>2</sup>. Blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.<sup>14</sup>, datë \*\*.4.2011, nga shtetasi \*\*\*.\*\*\* Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat nga pagat. Vlera: 1.837.305 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

2.2. Në DV-2011, subjekti ka deklaruar: *apartment në \*\*\*-Kavajë, me sipërfaqe 45,6 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.837.305 lekë. Burim krijimi për këtë pasuri është deklaruar: të ardhurat dhe kursimet (plotësuar me shkrim dore burimi). Pjesa takuese: ½.*

2.3. Lidhur me burimin e deklaruar: “*kursime nga të ardhurat nga pagat*”, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën mbi mundësinë financiare të subjektit për të investuar në këtë pasuri, duke u bazuar në të ardhurat e konfirmuara nga institucionet përkatëse dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] (i) *dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën - 1.603.951 lekë, sipas deklarimeve të kryera në deklaratat periodike vjetore, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie; (ii) dukej se kishte mospërputhje të deklaramit të subjektit në vitin 2011, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti, referuar dokumentacionit të lëshuar nga shoqëritë “\*\*\*.\*\*\*”, person fizik, dhe “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ku kishte punuar, krahasuar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore [...].*

2.4. Komisioni, në analizë të prapësimeve të subjektit, në përgjigje të barrës së provës, ka konkluduar se: [...] *Nisur nga fakti që u provua ligjshmëria e të ardhurave të bashkëshortit të*

<sup>13</sup> Nga analiza rezulton pamjaftueshmëri financiare prej - 2.389.419 lekë. Në këtë analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat neto të subjektit sipas vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, datë \*.1.2017, dhe Universitetit “A. Moisiu”, Durrës, si dhe të ardhurat neto të bashkëshortit nga punëdhënësi “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., bazuar në shkresën e ISSH-së, me nr. \*\*\* prot., datë \*.9.2019, dhe punëdhënësi “\*\*\*.\*\*\*”, bazuar në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë \*.11.2019, huat dhe dhurimet e deklaruara dhe të provuara; shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare, bazuar në të dhënat INSTAT, shpenzimet e udhëtimit sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe ndryshimet e likuiditeteve në llogaritë bankare.

<sup>14</sup> Subjekti ka deklaruar kontratë nr. \*\*\*/\*\*\*.

subjektit, të siguruara për vitet 2008 – 2012, nga punësimi në shoqërinë “\*\*\*\*.\*\*\*”, provohet edhe mundësia e krijimit të gjendjes cash një vit më parë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen me vend logjikën e përdorur nga subjekti se, për sa kohë është provuar se shuma 1.000.000 lekë ka qenë e mundur të kursehet nga bashkëshortët, kjo shumë, lehtësisht, mund të jetë investuar në blerjen e kësaj pasurie, duke qenë se në çdo rrethanë bie në sy fakti që si burim krijimi janë përdorur vetëm të ardhura të realizuara nga pagat e bashkëshortëve dhe, në këtë drejtim, blerja e pasurisë në muajin prill 2011 pranon përfshirjen e kursimeve të fillimvitit dhe të atyre të mbartura nga një vit më parë. Nën këtë analizë logjiko - juridike, por edhe matematikore, trupi gjykues çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie [...] <sup>15</sup>.

2.5. Nisur nga sa më sipër, Komisionit, nga analiza financiare deri në datën 11.4.2011, duke përfshirë të ardhurat nga paga e dy punëdhënësve të personit të lidhur të subjektit, shumën prej 400.000 lekë, deklaruar përfituar si paradhënie, si dhe pakësimin e gjendjes cash, të deklaruar vitin e mëparshëm në shumën 1.000.000 lekë, ka vlerësuar se subjekti: (i) ka shpjeguar bindshëm dhe ka faktuar me prova burimin e krijimit të shumës 5.125.734 lekë, shumë e krijuar nga të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\*\*.\*\*\*”, person fizik; (ii) ka bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës, dhe se (iii) rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie.

2.6. Ndërsa lidhur me pasurinë *automjet*, nga aktet në dosje ka rezultuar se pesë ditë mbrapa pagesës së apartamentit, subjekti i rivlerësimit, sikundër ka deklaruar dhe në D. Vett. dhe DV-2011, ka blerë edhe një *Automjet tip “Audi A2”*, viti i prodhimit 2001, me targa: \*\*\*, blerë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.4.2011, në shumën 3.000 euro. *Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna. Pjesa takuese 100%*. Në këto kushte, kur rezultoi se këto dy pasuri janë blerë afër në kohë dhe nuk ka pasur asnjë ndryshim në të ardhurat familjare, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, pasi dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare për të justifikuar blerjen e automjetit në shumën 3.000 euro.

2.7. Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se bashkëshorti, në datën \*\*.4.2011, ka marrë nga punëdhënësi “\*\*\*\*.\*\*\*”, person fizik, edhe shumën prej 500.000 lekë, në formën e paradhënies së pagave për periudhën prill - gusht 2011, duke vënë në dispozicion të Komisionit një dokument: *pasqyrë e llogarisë personale*, të datës \*\*.4.2011, ku pasqyrohet fakti se punëdhënësi i ka dhënë parapagim në lidhje me shërbimet që do të kryente bashkëshorti i subjektit, shumën prej 500.000 lekë. Edhe në këtë rast, Komisioni, bazuar në pretendimet dhe provat e subjektit, ka vlerësuar se subjekti ka kryer deklaram të mjaftueshëm lidhur me këtë pasuri (automjetin) dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj.

2.8. **Komisioneri Publik**, në analizë të rrethanave dhe situatës faktike të konstatuar si më sipër, vlerëson se konkluzionet e arritura nga Komisioni lidhur me këto dy pasuri nuk janë të bazuara në prova, në ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit.

---

<sup>15</sup> Faqe 17 e vendimit.

2.9. Pretendimet e subjektit mbi përdorimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në DV-2010, si burim për krijimin e pasurive dhe në mbulimin e shpenzimeve deri në datën 16.4.2011, mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara. Deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2 të Komisionit, mbi posedimin dhe ndryshimin e likuiditeteve në *cash*, për periudhën 2011-2016, nuk përputhen me deklaratat e vetë subjektit në deklaratat periodike vjetore, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, dhe në praktikën e Kolegjit, konsiderohen si provë e plotë. Duke qenë se kursimet në *cash* gjenden jashtë sistemit bankar dhe e vetmja mënyrë verifikimi janë deklaratat e subjektit në deklaratat periodike vjetore, në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ për përdorimin e tyre, nuk provojnë të kundërtën e barrës së provës. Vlerësimi i Komisionit dhe rishikimi i analizës financiare, duke marrë në konsideratë kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të barrës së provës, duket se nuk mbështetet në praktikën e konsoliduar gjyqësore të Kolegjit.

2.10. Bazuar në sa më sipër arsyetuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga analiza financiare e periudhës deri në 16.4.2011, duke përllogaritur vetëm burimet e ligjshme të të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, pa përfshirë vlerat e kursimeve/gjendje *cash* të deklaruara gjatë procesit të rivlerësimit, të ndryshme nga deklaratat në deklaratat vjetore periodike, rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurive: *Apartament banimi në \*\*\* – Kavajë dhe autoveturë “Audi”*.<sup>16</sup>

3. Në vlerësim të akteve të administruara në dosje të Komisionit, përveç sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk justifikojnë me të ardhura nga burime të ligjshme, edhe shpenzimet dhe kursimet e viteve 2012 dhe 2015<sup>17</sup>.

4. Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se problematikat e konstatuara mbi mungesën e të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet, çojnë në përfundimin se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe shërbejnë për të kualifikuar rastin konkret sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### **Kërkimi i ankimit**

5. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e

---

<sup>16</sup> Nga analiza financiare rezulton një diferencë negative, deri në datën 16.4.2011, në shumën prej – 849.435 lekë. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat për periudhën janar 2011- 16.4.2011, të subjektit, sipas vërtetimit të Prokurorisë Durrës, datë \*\*.1.2017; të ardhurat e bashkëshortit, sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë \*.11.2019, dhe të ardhurat e pretenduara të arkëtuara në formën e paradhënies dhe shpërbllimit nga “\*\*\*\*.\*\*\*”, person fizik; shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare për të njëjtën periudhë, shpenzimet për blerjen e pasurive dhe ndryshimet në likuiditetet në llogaritë bankare.

<sup>17</sup> Nga analiza financiare rezulton diferencë negative e vitit 2012, prej – 376.692 lekë, dhe për vitin 2015 diferencë negative prej – 262.928 lekë. Analiza e kryer për këto vite ka marrë në konsideratë: të ardhurat e subjektit sipas vërtetimit të Prokurorisë Durrës, datë \*.1.2017, dhe të ardhurat nga Universiteti “A. Moisiu”, Durrës; të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, punësimi pranë “\*\*\*\*.\*\*\*”, person fizik; nga aktiviteti i subjektit “\*\*\*\*.\*\*\*”. Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur bazuar në metodologjinë e përcaktuar nga KPA-ja, sipas jurisprudencës së deritanishme. Shpenzimet e jetesës janë llogaritur bazuar në standardin e përcaktuar nga ILDKPKI-ja, mbështetur në të dhënat e INSTAT. Shpenzimet e shkolimit dhe të mobilimit janë llogaritur bazuar në deklaratat e subjektit dhe të konfirmimeve të institucioneve përgjegjëse. Shlyerja e huas në monedhën euro, në mungesë të dokumentacionit provues, është konvertuar me kursin mesatar të monedhës euro të vitit përkatës.

rivlerësimi, ka të drejtën dhe detyrimin e kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe në një çmim të drejtë të provave të administruara;

6. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ligjit të zbatueshëm dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

7. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, pas vlerësimit në seancë publike të shkaqeve të ankimit që i përkasin procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**